



Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar

Albanian National Olympic Committee

Rr. "Muhamet Gjollësia", Sheshi Mustafa Q. Atatürk, ish 21 Dhjetori, Tiranë / P.O. Box 63
Tel: +355 4 2235 249 • E-mail: sekretariat@nocalbania.org.al • <http://www.nocalbania.org.al>

NJOFTIM PËR POZICION VAKANT

“Specialist Marketing, Rrjete Sociale dhe PR”

Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar (KOKSH) është një organizatë sportive Kombëtare e pavarur, themeluar në vitin 1958, pa qëllim fitimi, e organizuar mbi bazën e parimeve të Kartës Olimpike, dhe që funksionon sipas statutit të saj. KOKSH është organizata e vetme që përfaqëson Lëvizjen Olimpik Shqiptare, parimet e së cilës janë të detyrueshme për tu zbatuar nga të gjithë anëtarët e saj.

Në kuadër të Projektit “**Ekipe Sportive 2022**”, projekt i financuar nga Buxheti i Shtetit, KOKSH, fton kondidatët e interesuar për të aplikuar për pozicionin e punës “**Specialist Marketing, Rrjete Sociale dhe PR**”.

Objektivi i përgjithshëm i Projektit është krijimi i një Programi Kombëtar që nxit 1) sportin masiv, 2) zbulimin e talenteve, 3) edukatën sportive dhe parimet olimpikë. Projekti do të formojë Ekipe sportive jashtë shkollore në nivelin 9-vjecar (nga klasa e 6 – 9); në nivelin shkollë e mesme (nga klasa 10 – 12); në universitete.

Detyrat e Specialist Marketing, Rrjete Sociale dhe PR

Specialisti do të angazhohet gjatë hartimit, përpilimit, dhe zbatimit të planit të marketingut dhe promocionit të Projektit. Angazhohet gjatë hartimit, përpilimit, dhe zbatimit të fushatave promocionale të projektit dhe është përgjegjës për mediat sociale apo cdo komunikim publik në emër të projektit. Për të përmbushur objektivat e caktuara Specialisti i Marketingut duhet të kryejë detyrat si më poshtë:

- Zhvillimin dhe zbatimin e strategjive të Komunikimit dhe Marketingut të projektit;



Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar

Albanian National Olympic Committee

Rr. "Muhamet Gjollësia", Sheshi Mustafa Q. Atatürk, ish 21 Dhjetori, Tiranë / P.O. Box 63
Tel: +355 4 2235 249 • E-mail: sekretariat@nocalbania.org.al • <http://www.nocalbania.org.al>

- Krijon kontent cilësor sipas një kalendari specifik dhe ndjek përditësimin e tij në kanalet e komunikimit (web dhe rrjetet sociale);
- Koordinon punën me departamentin e medias në funksion të rritjes së audiencës së projektit;
- Kujdeset për marketingun tradicional, materialet promocionale apo broshura;
- Mat efektivitetin e kanaleve të komunikimit sipas audiencës së targetuar;
- Ruan marrëdhënie bashkëpunimi shumë të mira me departamentet e tjera të projektit;
- Synon përmirësimin dhe rritjen e imazhit të projektit;
- Përgjegjës për disenjimin dhe përmbajtjen e web-it bashkë me njësinë e medias;
- Përgjegjës për krijimin e brand/identitetit të projektit;
- Dizajn sipas përcaktimeve specifike kur është e nevojshme;
- Kryen funksione administrative në funksion të marketingut dhe PR-it të projektit.

Kualifikimet dhe Eksperienca:

- Minimumi një diplomë Bachelor në Marketing, design ose një fushë të ngjashme;
- E preferuar një diplomë Master në Marketing ose Biznes;
- Eksperiencë pune minimum 2 vjet;
- Njohuri të teknikave të marketingut online si dhe njohuri të dizajnit;
- Aftësi në zbatimin e aktiviteteve të marketingut;
- Të ketë njohuri të mira të gjuhës Angleze.

Aftësi dhe kompetenca kryesore

- Aftësi ndërpersonale, komunikim profesional verbal dhe të shkruar;
- Aftësi bashkëpunimi dhe ndërveprimi në ekip dhe me drejtuesit;
- Qasje pozitive dhe energjike në punë;
- Orientim ndaj detajeve dhe organizimit të proçeve të punës.





Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar

Albanian National Olympic Committee

Rr. "Muhamet Gjollësia", Sheshi Mustafa Q. Atatürk, ish 21 Dhjetori, Tiranë / P.O. Box 63
Tel: +355 4 2235 249 • E-mail: secretariat@nocalbania.org.al • <http://www.nocalbania.org.al>

Procedura e aplikimit

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë dokumentat e aplikimit si më poshtë:

- Curriculum vitae (CV) në formatin Europass;
- Letër Interesi;
- Fotokopje të diplomave universitare;
- Dokumente të tjera mbështetëse (çertifikata të fituara nga trajnime, pjesëmarrje në konferenca, botime, letra reference, etj).

Kandidatët e interesuar duhet t'i dërgojnë dokumentet e aplikimit deri më datë 12 Maj 2022, ora 16.00, në adresën secretary.general@nocalbania.org.al , me subjekt: **Aplikim për pozicionin Specialist Marketing, Rrjete Sociale dhe PR "Ekipet Sportive 2022"**.

